



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:061501

Datë: 19.06.2020

Numri i dokumentit: 00975113

P.nr.1019/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja e vetme gjykuese Medie Bytyçi me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Sadije Sogojeva, në çështjen penale kundër të pandehurit F. K., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184, par.1, të KPRK-së, Nr.06/L-74, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3567/2019, të dt.28.05.2020, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.3567/2019, të dt.28.05.2020, jashtë seancës, më dt 12.05.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3567/2019, të dt.28.05.2020, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

F. K., nga babai A. dhe nëna S., e gjinisë S., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, me vendbanim në Fushë Kosovë, Rr. "B. B., nr. *numer...*, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së ulët ekonomike, i martuar, nuk ka dokument personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 23.07.2019, rreth orës 12:30 në Fushë Kosovë, në rrugën "D.", në lokalin "AM", në pronën e A. A., si pasojë e një mosmarrëveshje lidhë me çështjet e biznesit në mes tyre, i Pandehuri F. K. me dashje ka sulmuar fizikisht të dëmtuarën Sh. U. K., në atë mënyrë që, fillimisht me forcë me duar e ka kapur për flokësh dhe më pas e ka shtrënguar për qafe po ashtu me duar, si dhe duke e shtyrë e ka rrëzuar për toke disa herë, me këtë rast e dëmtuara si pasojë e këtyre veprimeve ka kërkuar trajtim mjekësor dhe njëherit i'u është cenuar integriteti trupor,

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.1, të KPRK-së,

Andaj, gjykata konform neneve 4; 7; 17; 21;38 ; 39; 40; 43; 69 të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 495 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 € (dyqind) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar, i pandehuri mund ta paguaj deri në dy këste mujore me së largu deri me datën 5 të muajit vijues.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo njëzet (20) euro me një (1) ditë burgim.

Obligohet: i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet) euro, në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) euro dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej njëzetë e pesë (25) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

E dëmtuara: Sh. K., me vendbanim në, Fushë Kosovë, me nr.pers. *numri...*, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest juridiko – civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës PP.II.nr.3567/2019, të dt.28.05.2020, e ka akuzuar për veprën penale Sulm nga neni 184 par., të KPRK-së, (Nr. 06/L-74 ) dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me bazueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja individuale, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së të KPPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se nga shkresat e lëndës dhe provat e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe atë: Raporti Policisë, me nr. 2019-AE-0734 të datës 26.07.2019, Mendimi i ekspertit Mjeko-Ligjor, Dr. Flamur Dylhasi i datës: 27.08.2019, deklaratat e palëve lidhur me rastin, si dhe shkresat tjera në lëndë, janë prova të besueshme, mbi bazën e të cilave, vërtetohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me lartësinë e dënimit dhe mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë, Gjykata ka vlerësuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu gjykata ka vlerësuar se mundësia e pagesës me këste nuk do ta rrezikonte gjendjen materiale të të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së. Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit. Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal  
Pr.nr.1019/2020 të dt.12.05.2020

Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Medie Bytyçi

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, në këtë gjykatë.